


Analizë e opinionit publik No.33/2021

# Njeri i popullit: Analizë e opinionit publik mbi kërkesat politike të qytetarëve

Autorë: Jovan Blizankovski, Vlora Reçica, Misha Popoviç dhe Toshe Zafirov

nëntor 2021



FRIEDRICH  
EBERT  
STIFTUNG



NDI  
NATIONAL  
DEMOCRATIC  
INSTITUTE

IDSCS | Instituti për demokraci  
Societas Civilis - Shkup



*“Qëndrimet në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë pozitën zyrtare e Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kabinetit të presidentit, Qendrës presidenciale për edukim politik pranë Kabinetit të presidentit dhe organizatave partnere. Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave të paraqitura në publikim është e autorëve dhe hulumtuesëve”.*

# Impressum

<b>Titulli:</b>	Njeri i popullit: Analizë e opinionit publik mbi kërkesat politike të qytetarëve
<b>Titulli i origjinalit:</b>	Човек од народот: Анализа на јавното мислење за политичките барања на граѓаните
<b>Botues:</b>	Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup
<b>Autorë:</b>	Jovan Blizankovski, Vlora Reçica, Misha Popović dhe Toshe Zafirov
<b>Përkthimi në gjuhën maqedonase:</b>	Vjosa Taipj
<b>Dizajni:</b>	Dejan Kuzmanovski

## Publikimi mund të shkarkohet falas në:

<http://www.idscs.org.mk>

### CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

316.46:32]:316.654(497.7)(047.31)

32.019.5:316.654(497.7)(047.31)

NJERI i popullit : analizë e opinionit publik mbi kërkesat politike të qytetarëve : analizë e opinionit publik No.33/2021 / autorë Jovan Blizankovski ... [и др.] ; [përkthimi në gjuhën maqedonase Vjosa Taipj]. - Skopje : Institute for Democracy "Societas Civilis", 2021 . - [26] стр. : илуст. ; 21 см

Превод на делото: Човек од народот : анализа на јавното мислење за политичките барања на граѓаните. - Фусноти кон текстот. - Други автори: Vlora Reçica, Misha Popović dhe Toshe Zafirov

ISBN 978-608-266-016-5

1. Blizankovski, Jovan [автор] 2. Reçica, Vlora [автор] 3. Popović, Misha [автор] 4. Zafirov, Toshe [автор]  
а) Популизам -- Политички елити -- Јавно мислење -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 55538693

# I. Metodologjia

---

Numri i pyetjeve: **56**

Mostra: **N = 1000 (18 vjeç + të anketuar në të gjithë territorin e vendit)**

Metoda: **studim në terren, sy më sy**

Periudha: **10 - 25 qershor 2021**

Gabim statistikor: **± 3%**.

## II. Hyrje

---

Populizmi ka qenë një nga termat kyç në jetën politike të shumë vendeve gjatë njëzet viteve të fundit. Shpesh e përcaktuar si një ideologji “e butë” sipas së cilës “populli” kundërshton elitat politike në një luftë të vazhdueshme për pushtet politik, populizmi përdoret gjerësisht nga udhëheqësit politikë me prejardhje të ndryshme në spektrin politik për të fituar ose mbajtur pushtetin. Një studim i fundit (2019), i cili fokusohet në 40 demokraci në periudhën 1998-2018, vlerësoi se retorika populiste është dyfishuar në dy dekadat e fundit dhe se ajo është karakteristikë e disa demokracive të zhvilluara, ku si më dominues paraqitet populizmi djathtist.<sup>1</sup> Vendet e Ballkanit Perëndimor gjithashtu nuk janë immune ndaj këtij trendi botëror. Udhëheqës të shumtë dhe parti politike në rajon mund të identifikohen si populiste, duke pasur parasysh prirjen e tyre për retorikë populiste,<sup>2</sup> praktika autoritare,<sup>3</sup> si dhe prirjen për zgjidhje të paqëndrueshme në drejtim të krijimit të politikave publike.

---

<sup>1</sup> Shih: Lewis Paul, Caelainn Barr, Seán Clarke, Antonio Voce, Cath Levett dhe Pablo Gutiérrez. 2019. “Revealed: The Rise and Rise of Populist Rhetoric”. The Guardian, 6 March 2019. [https://www.theguardian.com/world/ng-interactive/2019/mar/06/revealed-the-rise-and-rise-of-populist-rhetoric?fbclid=IwAR3wsrLFSG4NSWskMSIkT5liJbGS\\_Iydy-E-2-UGkQzc1ye8nZZoFY-feSo](https://www.theguardian.com/world/ng-interactive/2019/mar/06/revealed-the-rise-and-rise-of-populist-rhetoric?fbclid=IwAR3wsrLFSG4NSWskMSIkT5liJbGS_Iydy-E-2-UGkQzc1ye8nZZoFY-feSo).

<sup>2</sup> Shih, për Maqedoninë (e Veriut): Petkovski, Ljupcho. 2015. Authoritarian Populism and Hegemony: Constructing ‘the People’ in Macedonia’s Illiberal Discourse. Contemporary Southeastern Europe 3 (2): 44–66. [http://www.contemporarysee.org/sites/default/files/papers/petkovski\\_authoritarian\\_populism\\_and\\_hegemony\\_0.pdf](http://www.contemporarysee.org/sites/default/files/papers/petkovski_authoritarian_populism_and_hegemony_0.pdf); për Kosovë: Yabanci, Bilge. 2015. Populism and Anti-Establishment Politics in Kosovo: A Case Study of Lëvizja Vetëvendosje. Contemporary Southeastern Europe 3(2): 17– 43. [http://www.contemporarysee.org/sites/default/files/papers/yabanci\\_politics\\_in\\_kosovo.pdf](http://www.contemporarysee.org/sites/default/files/papers/yabanci_politics_in_kosovo.pdf); dhe për Malin e Zi: Džankić, Jelena, and Soeren Keil. 2017. “State-Sponsored Populism and the Rise of Populist Governance: The Case of Montenegro.” Journal of Balkan and Near Eastern Studies 19 (4): 403– 18. <https://doi.org/10.1080/19448953.2017.1280981>.

<sup>3</sup> Shih: Bieber, Florian. 2020. The Rise of Authoritarianism in the Western Balkans. New Perspectives on South-East Europe. Cham, Switzerland: Palgrave Macmillan.

Megjithëse populizmi në mënyrë deklarative e vendos "popullin" në qendër të luftës politike, besohet gjerësisht se dobësitë e diskursit populist i tejkalojnë përparësitë. Ekziston një konsensus i fortë në literaturën akademike se populizmi kontribuon drejt shfaqjes së tendencave autoritare të udhëheqësit politikë dhe në dobësimin e demokracisë.<sup>4</sup> Populizmi shpesh është përgjegjës për ad hoc zgjidhje të dëmshme për ushtrimin e pushtetit publik, të cilat synojnë të plotësojnë nevojat afatshkurtra të grupeve të ndryshme shoqërore, ndërkaq të cilat nuk ofrojnë një përgjigje të qëndrueshme ndaj problemeve sociale. Si i tillë, populizmi stimulon politika publike të papërshtatshme dhe shpenzime të papërgjegjshme të mjeteve publike. Shkurtpamësia e tillë në ushtrimin e pushtetit publik, në kombinim me retorikën "luftarake" dhe nxitëse populiste, shpesh mund të stimulojë konflikte sociale që shkaktojnë dëme të konsiderueshme në shoqëritë demokratike.

Ky hulumtim fokusohet mbi kërkesën shoqërore për udhëheqës dhe politika populiste në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Çdo mobilizim politik - përfshirë politikë të bazuar në retorikën dhe metodat populiste - ka anën e vet të ofertës (supply) dhe kërkesës (demand). Ana e ofertës është formuar nga partitë politike dhe politikanët të cilët mbështeten në diskursin populist kur marrin pjesë në garën demokratike. Ana e kërkesës formohet në një nivel social, midis qytetarëve dhe grupeve të ndryshme sociale. Këto dy tendenca për populizmin - nga lart poshtë dhe nga poshtë lart - janë të ndërthurura. Oferta e populizmit mund të stimulojë kërkesën tek qytetarët dhe anasjelltas. Udhëheqësit politikë të orientuar strategjikisht, të cilët kanë dëshirë për sigurim ose mbajtjen e pushtetit mund të përdorin pikëpamjet populiste të popullata për të arritur qëllimet e tyre. Për këtë arsye, hulumtimi i kërkesës për populizmin në një shoqëri është me rëndësi të veçantë për ballafaqimin me pasojat e një dukurie të tillë politike.

Në hulumtimin në terren të kryer nga Instituti për Demokraci "Societas Civilis" Shkup (IDSCS) në bashkëpunim me Qendrën Presidenciale për Arsim Politik, populizmi përkufizohet si një ideologji "e butë" që konsideron se shoqëria, mbi të gjitha, është e ndarë në dy grupe homogjene dhe kundërshtarë, njerëzit e thjeshtë, pra "populli", përkundër "elitës së korruptuar"; dhe i cili pohon se politika duhet të jetë shprehje e vullnetit të përgjithshëm të popullit.<sup>5</sup> Populizmi është një ideologji "e butë" sepse, për dallim nga ideologjitë e tjera tradicionale politike (si liberalizmi, konservatorizmi dhe socializmi), nuk ka postulate "më të forta" që informojnë veprimin politik. Te populizmi, premisa e vetme ideologjike konsiston në idenë se "populli" dhe "elitat" janë

<sup>4</sup> Shih: Mudde, Cas and Cristóbal Rovira Kaltwasser. 2017. Populism: A Very Short Introduction. Oxford: Oxford University Press, f.18-19.

<sup>5</sup> Përkufizimi i përdorur është karakteristik për të ashtuquajturën "Qasje ideore" ndaj populizmit, e cila e koncepton populizmin si diskurs, botëkuptim ose ideologji "e butë/hollë". Shih: Ibid., f. 5-9.

në thelb të kundërshtuar dhe në konflikt të vazhdueshëm, gjatë çka “populli” ka rolin pozitiv dhe “elitën” rolin negativ. Populistët dallojnë në mënyrën se si përkufizojnë “popullin”, por në përgjithësi ai përkufizim thjeshtohet dhe bazohet mbi një element identifikues, siç është për shembull klasa, grupi etnik ose kombëtar. Njëkohësisht, populistët zakonisht e paraqesin “elitën” si një institucion politik, ekonomik, kulturor dhe mediatik, i portretizuar si entitet homogjen që vendos interesat e veta, ndërsa shpesh edhe interesat e korporatave të mëdha, vendeve të huaja ose emigrantëve - mbi interesat e “popullit”.

Duke marrë parasysh karakterin e populizmit, ky hulumtim nisët nga ideja se botëkuptimi populist ka katër karakteristika kryesore: **mosbesim i theksuar ndaj elitave politike, të cilët përgjithësisht perceptohen si të korruptuar dhe kryesisht të interesuar për veten; ideja se “populli” është entitet që është moralisht superior ndaj elitave; mosbesim i theksuar ndaj institucioneve demokratike dhe rregullave të lojës; si dhe kuptim i politikës dhe jetës politike përmes prizmit konfrontues të “ne kundrejt tyre”**. Në hulumtim, ne u përpoqëm të vlerësojmë se sa secila nga këto karakteristika është e pranishme në mesin e popullatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kërkesa për populizëm në vend kryesisht vlerësohet përmes pajtimit me pohimet, që të anketuarit marrin si pyetje sondazhi, të cilat i referohen katër karakteristikave të përmendura më lart.<sup>6</sup> Për shumicën e pohimeve, pajtimi korrespondon me qëndrim populist, ndërsa në një masë më të vogël, mos pajtimi karakterizon populizmin. Përveç komponentit ideologjik “të butë”, ne gjithashtu u përpoqëm të vlerësojmë se si karakteristikat personale / biografike të kandidatëve politikë ndikojnë mbi sjelljen e votuesve. Këtë e bëmë përmes një eksperimenti të specializuar të anketës, mbi sjelljen zgjedhore, në të cilin të anketuarit mundën të “votojnë”, domethënë të zgjedhin midis një “politikani karriere” dhe një “njeriu të popullit”. Për më tepër, matëm tendencën e popullsisë drejt teorive të komplotit, si edhe një tregues tjetër që lidhet me retorikën populiste që krijon mosbesim të përgjithshëm tek qytetarët, si dhe (mos) besimin në institucionet demokratike, gjë që rezulton me prirje më të madhe ndaj udhëheqësve dhe politikave populiste. Ky raport është produkti fillestar i sondazhit të kryer në qershor 2021, me qëllim të informimit të publikut të gjerë në lidhje me pikëpamjet politike të qytetarëve të Maqedonisë së Veriut. Gjetjet më të rëndësishme nga ky hulumtim janë paraqitur më poshtë.

---

<sup>6</sup> Në përgatitjen e pyetjeve të anketës në lidhje me karakteristikat populiste të të anketuarve, ne u mbështetëm në një instrument të zhvilluar nga Akkerman et al. (2014) dhe Spruyt et al. (2016) dhe aplikuar në Hollandë dhe Belgjikë, respektivisht. Instrumenti i aplikuar në Maqedoninë e Veriut bazohet në këto dy studime, me modifikime të caktuara në përputhje me kontekstin maqedonas. Shih: Akkerman, Agnes, Cas Mudde dhe Andrej Zaslove. 2014. *How Populist Are the People? Measuring Populist Attitudes in Voters*. Comparative Political Studies, Vol 47, Issue 9, 2014. <https://doi.org/10.1177/0010414013512600>; dhe Spruyt, Bram, Gil Keppens and Filip Van Droogenbroeck. 2016. *Who Supports Populism and What Attracts People to It?*. Political Research Quarterly, Vol 69, Issue 2, 2016. <https://doi.org/10.1177/1065912916639138>.


### III. Gjetjet e hulumtimit

#### • Politikanët që punojnë vetëm për veten e tyre

Ideja që politikanët në Republikën e Maqedonisë së Veriut punojnë ekskluzivisht për realizimin e interesave të tyre personale, në krahasim me interesin e përgjithshëm, është fuqishëm e pranishme në mesin e popullatës. Kështu, për shembull, shumica dërrmuese e të anketuarve pajtohen me pohimin “Politikanët dhe elita shpesh tradhtojnë popullin” (86%); “Politikanët më shumë flasin sesa që ndërmarrin diçka” (83%); dhe “Politikanët që pretendojnë se mbrojnë interesat tona në fakt kujdesen vetëm për veten e tyre” (82%). Njëkohësisht, shumica dërrmuese prej 81% e të anketuarve pajtohen se “Sapo të fitojnë zgjedhjet, politikanët mendojnë se janë më të mirë se njerëzit si unë”, ndërsa më pak se 5% e tyre shprehën mospajtim me këtë pohim. Asnjë dallim i rëndësishëm nuk u identifikua midis kategorive demografike në lidhje me këto katër pretendime, një gjetje që tregon se perceptim i theksuar negativ i politikanëve mbizotëron në mesin e qytetarëve pavarësisht nga prejardhja e tyre demografike.

Të anketuarit tregojnë qëndrime dukshëm më të moderuara ndaj dy grupeve të elitave, elitave ekonomike dhe ekspertëve, të cilat janë gjithashtu të rëndësishme për jetën politike në vend.

**Grafiku 1.** Qëndrimet ndaj elitave politike (% e pajtimit me pohime)






Shumica e të anketuarve pajtohen me pohimin “Vendi ynë do të qeveriset më mirë nëse vendimet e rëndësishme u lihen biznesmenëve të suksesshëm” (43%), ndërsa afërsisht një e katërta (24%) nuk pajtohen, një konstatim që zbulon se elitat ekonomike gëzojnë besim shumë më të lartë në aspektin e qeverisjes së shtetit nga elitat politike. Me këtë deklaratë janë pajtuar shumica e votuesve të VMRO-DPMNE-së (53%) si dhe abstenuesit (50%), ndërsa kjo nuk ndodh me asnjë nga partitë e tjera politike (ku pajtimi, edhe pse dominues, është më i moderuar). Shumica e të papunëve (53%) gjithashtu pajtohen me këtë pohim.

Nga ana tjetër, shumica e të anketuarve treguan mosbesim ndaj elitave të ekspertëve duke u pajtuar me pohimin “Nuk mund t’u besohet ekspertëve që shfaqen në televizion” (47%), ndërsa pak më shumë se një e pesta e të anketuarve shprehën mendimin e kundërt (21%). Ekspertët kanë mosbesim dukshëm më të lartë tek të anketuarit shqiptarë sesa tek të anketuarit maqedonas. Një shumicë domethënëse prej 65% e të anketuarve shqiptarë pajtohen me pohimin “Ekspertëve që shfaqen në televizion nuk mund t’u besohet”, krahasuar me 44% të të anketuarve maqedonas. Shumica e votuesve të Aleancës për Shqiptarët (59%) dhe BDI-së (57%) u pajtuan me deklaratën, ndërsa votuesit e LSDM-së janë i vetmi grup votues ku më shumë të anketuar nuk janë pajtuar me deklaratën sesa janë pajtuar (38% kundrejt 35%). Ekspertët kanë më shumë mosbesim te burrat sesa gratë: një shumicë prej 54% e burrave pajtohen me pohimin, krahasuar me 43% të grave. Dy grup moshat më të reja (18 - 29 vjeç dhe 30 - 39 vjeç) gjithashtu kryesisht pajtohen me pohimin se ekspertëve nuk mund t’u besohet (53% dhe 58% në mënyrë përkatëse), ndërsa në kategoritë e tjera të moshës nuk është kështu.

**Grafiku 2.** Qëndrimet ndaj elitave ekonomike dhe ekspertëve (% pajtimit me pohime)




## • *Populli kundër elitave*

Ideja që elitat politike dhe njerëzit kundërshtohen fuqishëm, gjatë çka “populli” shihet si një forcë homogjene dhe moralisht superiore, që është gjithashtu e përhapur në mesin e popullatës, pa dallime të dukshme midis grupeve të ndryshme demografike. Deri në 69% të të anketuarve pajtohen me pohimin “Dallimet politike midis njerëzve dhe elitave janë më të mëdha se dallimet në mesin e popullit”, ndërsa një pakicë e vogël prej 9% mendojnë të kundërtën. Njëkohësisht, ideja që njerëzit e zakonshëm, pra “populli”, duhet të kenë përparësi para elitave politike në vendimmarrjen politike është gjithashtu shumë e pranishme. Rreth 85% e të anketuarve pajtohen me pohimin “Politikanët duhet të ndjekin vullnetin e popullit”, ndërsa 70% pajtohen me pohimin “Populli, jo politikanët, duhet të marrin vendimet më të rëndësishme politike”. Për më tepër, një shumicë e konsiderueshme prej 68% e të anketuarve pajtohen me pohimin “Më shumë do të kisha dashur të përfaqësohem nga njeri i popullit sesa nga një politikan me profesion”, ndërsa vetëm 11% e të anketuarve nuk pajtohen me të njëjtën gjë, një gjetje që ilustron se në mesin e popullsisë është e pranishme kërkesa e konsiderueshme për udhëheqës politikë më afër njerëzve të zakonshëm.

Megjithatë, qytetarët janë të ndarë sa i përket pohimit “Politikanët duhet të udhëheqin, jo të ndjekin popullin”, gjatë çka, numër më i madh i të anketuarve pajtohen sesa nuk pajtohen me këtë pohim (42% kundrejt 35%). Ndarja është më e theksuar tek më të rinjtë (18-29 vjeç) dhe në grupmoshën më të vjetër (60+ vjeç), ku afërsisht i njëjti numër i të anketuarve pajtohen dhe nuk pajtohen me pohimin. Pajtimi me këtë pohim, në mesin e kategorive “statusi i punës”, nga ana tjetër, është më e theksuar në mesin e punonjësve në sektorin publik, ku gjysma e të anketuarve pajtohen (51%), dhe ky nuk është rasti me asnjë nga grupet e tjera. Të anketuarit që jetojnë në zonat urbane pajtohen më shumë me pohimin sesa të anketuarit që jetojnë në zonat rurale (47% kundrejt 39%).

**Grafiku 3.** Qëndrimet në lidhje me marrëdhëniet midis “popullit” dhe elitave politike (% e pajtimit me pohim)



### • “Politikan me karrierë” ose “Njeri i popullit”


Me qëllim të kuptojmë më shumë rreth preferencave votuese të të anketuarve, ndërkaq në lidhje me karakteristikat personale / biografike të kandidatëve, në pyetësor kemi përfshirë një eksperiment për sjelljen zgjedhore (votuese). Të anketuarit morën një skenar biografik fiktiv për dy kandidatë dhe u pyetën se për kë do të votonin. Kandidatët u ndanë në “politikan karriere” (kandidati 1) dhe “njeri i popullit” ose “autsajder” (kandidat 2), ndërsa të anketuarve u ishte kërkuar të imagjinonin se po përgatiteshin për të votuar në zgjedhjet parlamentare. Atyre iu paraqit një skenar në të cilin, sipas sondazheve, dy kandidatë me partitë e tyre janë në një “garë të vdekur” për fitore, domethënë të dy kandidatët janë shumë të popullarizuar në mesin e qytetarëve dhe u jepen shanse të barabarta për t’i fituar zgjedhjet. Sipas skenarit, programet politike të dy kandidatëve nuk ndryshojnë, d.m.th., secili prej kandidatëve u premtun qytetarëve një jetë më të mirë, por të dy theksojnë se për ta arritur këtë, nevojiten ndryshime të vështira dhe afatgjata politike, ekonomike dhe sociale. Pastaj të anketuarve iu prezantuan “biografite” e kandidatëve dhe ata u pyetën se cili nga dy kandidatët, sipas tyre, ka shans më të mirë për ta përmbushur premtimin, pra të sjellë një jetë më të mirë për qytetarët në vend.

**Kandidati 1 (politikan karriere):** (Emri i shpikur 1)<sup>7</sup> ka lindur në vitin 1976. Është anëtar i një prej partive kryesore që nga rinia e tij dhe ka kaluar të gjitha nivelet e partisë përpara se të vinte në krye të partisë. Udhëheq partinë që nga viti 2017. Në periudhën 2013-2016 ushtronte funksionin drejtor i ndërmarrjes së qytetit për ujë, dhe në periudhën 2016-2017 ishte Zëvendësministër i Vetëqeverisjes Lokale. Ka kryer studimet universitare dhe pasuniversitare në shkencat politike. Ai është i martuar me deputeten aktuale (Emri i shpikur 1.1), me të cilën ka dy fëmijë. Jeton dhe punon në Shkup.

**Kandidati 2 (njeri nga populli):** (Emri i shpikur 2) lindi në 1978. Është themeluesi i një prej partive më të vogla, e formuar kohë më parë në vitin 2017, dhe deri më tani nuk ka shënuar rezultat të rëndësishëm në zgjedhje. Në politikë hyn dhe fiton popullaritet duke ndihmuar komunitetin lokal. Deri më tani, nuk ka ushtruar funksion publik, dhe në të kaluarën ka punuar si nëpunës në një ndërmarrje publike për shpërndarjen e energjisë elektrike. Ka përfunduar studimet universitare në inxhinieri elektrike. Është i martuar me (Emri i shpikur 2.2), një pedagoge, dhe ka dy fëmijë me të. Jeton dhe punon në Shkup.

**Dy të pestat e të anketuarve (42%) u përgjigjën se**, nëse në zgjedhjet parlamentare para tyre në fletëvotim do të ishin kandidatët 1 dhe 2, **ata do të votonin për kandidatin e dytë**, d.m.th., për kandidatin që themeloi partinë e tij dhe nuk kishte mbajtur funksion publik deri në momentin e zgjedhjeve. Nga ana tjetër, pothuajse një e treta (31%) e të anketuarve u përgjigjën se do të votonin për kandidatin e parë, d.m.th., sipas kategorizimit, për politikanin e karrierës. 22% e të anketuarve ishin të pavendosur, ndërsa 5% refuzuan t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

**Grafiku 4.** Për cilin kandidat do të votonit në zgjedhje? (%)




<sup>7</sup> Kandidatët janë emëruar në varësi të gjuhës në të cilën është kryer anketa, pra nëse është kryer në gjuhën maqedonase, të anketuarit i është paraqitur kandidati me emër maqedonas, dhe nëse anketa është kryer në gjuhën shqipe, të anketuarit i është paraqitur kandidati me emër shqiptar.

Në një analizë më të detajuar të të dhënave, ne u përpoqëm të zbulonim se cili nga dy kandidatët do të zgjidhej nga votuesit e partive politike tashmë ekzistuese në Maqedoninë e Veriut. Votuesit e VMRO-DPMNE janë të ndarë në mendimet e tyre. 57% e të anketuarve që janë përgjigjur se nëse zgjedhjet do të mbaheshin javën e ardhshme do të votonin për VMRO-DPMNE-në dhe koalicionin, kanë zgjedhur kandidatin e dytë nga eksperimenti, ndërsa 43% kanë zgjedhur të parin. Në anën tjetër, votuesit e LSDM-së preferojnë profilin e kandidatit të parë, me gati dy të tretat e të anketuarve që thonë se do të votonin për të (65%). Situata me votuesit e BDI-së është më e qartë, me faktin se ata shprehimisht preferojnë kandidatin e parë (78%), d.m.th. politikan karriere. Nga ana tjetër, votuesit e opozitës shqiptare kanë një tjetër preferencë, ku 65% e të anketuarve që do të votonin për "Aleancën për Shqiptarët" nëse zgjedhje do të mbaheshin javën e ardhshme, preferojnë këtë të fundit, apo kandidati i paraqitur si "njeri i popullit". 83% e të anketuarve që janë përgjigjur se nëse zgjedhjet do të mbaheshin javën e ardhshme do të votonin për "Të majtën" për lider politik preferojnë profilin e kandidatit të dytë.

Të dhënat tregojnë se ka një ndarje të dukshme mes votuesve të dy partive më të mëdha politike në vend, ku votuesit e VMRO-DPMNE-së në përgjithësi preferojnë kandidatin e dytë, ndërsa votuesit e LSDM-së arë të parin. Gjithashtu ka një tendencë që votuesit e partive politike në pushtet të preferojnë profilin e kandidatit të parë, në krahasim me votuesit e partive opozitare, të cilët në mënyrë eksplicite preferojnë profilin e kandidatit të dytë. Qytetarët që thanë se nuk do të votonin në zgjedhje, në eksperiment zgjedhën kandidatin e dytë (75%).

**Grafiku 5.** Për cilin kandidat do të votonin në zgjedhje sipas preferencave politike (%)




Sa i përket përkatësisë etnike të votuesve, maqedonasit janë të prirë të votojnë për kandidatin e dytë (58%), ndërsa situata me elektoratin shqiptar është e ndarë, ku 49% e të anketuarve preferojnë kandidatin e dytë dhe 51% të parin. Ndërsa të anketuarit me arsim fillor dhe të lartë janë të ndarë në mendimet e tyre, të anketuarit me arsim të mesëm kryesisht preferojnë kandidatin e dytë (63%). Ekzistojnë gjithashtu dallime midis të anketuarve me status të ndryshëm punësimi, me të anketuarit e punësuar në sektorin publik që preferojnë kandidatin e parë (59%), ndërsa të anketuarit të punësuar në sektorin privat (61%), të vetë punësuarit dhe profesionistët e pavarur (65%), studentët (73%), pensionistët (54%) dhe të anketuarit e papunë (68%) preferojnë kandidatin e dytë. Kandidatin e dytë e preferojnë edhe të anketuarit më të rinj, ata deri në 29 vjeç (63%), si dhe të intervistuarit midis 50 dhe 59 vjeç (66%) dhe 60+ (58%). Më të ndarë në preferencat e tyre janë të anketuarit që i përkasin grup moshës nga 30 deri në 49 vjeç.

### **• *Nga mosbesimi ndaj elitave në zhgënjim nga rregullat demokratike***

Mosbesimi i konsiderueshëm ndaj elitave dhe partive politike reflektohet gjithashtu në mosbesimin ndaj mekanizmit kryesor demokratik - zgjedhjeve, si dhe vetë aktit të votimit, i cili për shumicën dërrmuese të të anketuarve është zhgënjyes. Pjesa dërrmuese prej 76% e të anketuarve u pajtuan me deklaratën "Votimi nuk do të thotë asgjë, partitë politike sigurisht bëjnë vetëm atë që duan", dhe vetëm 8% nuk pajtohen, një konstatim që ilustron mosbesimin e konsiderueshëm ndaj aktit të votimit për sa i përket mundësive për të "disiplinuar" elitat dhe partitë. Përveç kësaj, 82% e të anketuarve pajtohen që partitë politike janë të interesuara vetëm për votat, por jo për opinionet e qytetarëve (deklarata: "Partitë janë të interesuara vetëm për votën time, jo mendimin tim"). Rrjedhimisht, për një shumicë të konsiderueshme të qytetarëve, votimi nuk paraqet mundësi për të ndikuar në sjelljen e elitave dhe partive politike, një situatë që paraqet largim domethënës nga modeli ideal i demokracisë, në të cilin politikanët janë të përgjegjshëm dhe përgjigjen para qytetarëve përmes mekanizmit demokratik kryesor - zgjedhjet.

Pamundësia për të kontrolluar elitat dhe partitë lidhet me një ndjenjë të reduktuar të përgjegjësisë qytetare në lidhje me votimin. Kështu, një numër solid i të anketuarve (43%) pajtohen se vota e tyre nuk është veçanërisht e rëndësishme (deklarim: "Aq shumë njerëz votojnë në zgjedhje sa që njëra nga votat e mia pak a shumë nuk bën dallim"), ndërsa një numër më i vogël (36%) mendojnë të kundërtën. Ky qëndrim apatik është më i pranishmi në kategorinë më të re të moshës (18-29 vjeç), të cilët në shumicën prej 56% pajtohen, dhe më së paku të pranishëm në kategorinë e moshës së dytë (30-39 vjeç), të cilët pajtohen në 38%. Pothuajse gjysma e të anketuarve me arsim fillor pajtohen se vota e tyre në zgjedhje nuk bën ndonjë ndryshim (49%), ndërsa (dhe anasjelltas) pothuajse gjysma e të anketuarve me arsim të lartë nuk pajtohen me deklaratën (49%). Shumica e votuesve të LSDM-së (53%) dhe të Majtës (51%) nuk pajtohen me pohimin se vota personale nuk bën dallim, ndërsa shumica e votuesve të BDI-së mendojnë të kundërtën (59%), si dhe shumica e votuesve të VMRO-DPMNE-së (47%) dhe Aleancës për Shqiptarë (45%).

**Grafiku 6.** Qëndrimet për zgjedhjet dhe votimin(% e pajtimit me pohime)




## • Besueshmëria në institucionet demokratike

Hulumtimi gjithashtu shqyrtoi besueshmërinë e qytetarëve në institucionet demokratike, si dhe në aktorët e tjerë në jetën politike të shtetit dhe shoqërisë, siç janë media, organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat fetare. Të anketuarit u pyetën se sa u besojnë institucioneve dhe palëve të tjera të interesit në shkallë prej 1 deri në 10, ku 1 do të thotë se nuk u besojnë aspak, ndërsa 10 që u besojnë plotësisht.

Bazuar në vlerësimet e dhëna nga të anketuarit për këtë çështje, mund të vërehet se besimi në institucionet më të rëndësishme brenda sistemit politik të Maqedonisë së Veriut, si Parlamenti, Qeveria, Presidenti dhe gjyqësori, është në nivel të ulët. Shprehur me notë mesatare, Kuvendi vlerësohet me 3.5 nga të anketuarit, që është në të njëjtin nivel me notën e besimit për Qeverinë (3.5). Notën më të lartë të besimit e ka Presidenti i vendit me 4.4, ndërsa notën më të ulët të besimit e ka gjyqësori, me rezultat mesatar prej 2.8. Pothuajse 5 nga 10 qytetarë e vlerësuan gjyqësorin me notën 1, përkatësisht u përgjigjën se nuk i besojnë gjyqësorit aspak. Kjo dërgon një mesazh të fortë në lidhje me perceptimet e qytetarëve për sundimin e ligjit, luftën kundër korrupsionit, pavarësinë e gjyqësorit dhe efikasitetin e gjykatave. Vlerësimi i besimit në institucionet kryesore në sistemin politik, sipas përkatësisë etnike, kryesisht tek maqedonasit dhe shqiptarët, ndjekin vlerësimet e përgjithshme dhe trendin e përgjithshëm, përveç devijimit në vlerësimin e Presidentit, i cili në komunitetin etnik shqiptar është 3.4, ndërsa në komunitetin etnik maqedonas është 4.7.


**Grafiku 7.** Niveli i besimit në institucionet demokratike (në shkallë prej 1 deri në 10)






Sipas statusit të punësimit, të papunët kanë besimin më të ulët në Qeverinë, me notën 2.8, dhe besimi për Kuvendin është më i ulëti te studentët, të cilët dhanë notën 3.0. Presidenti dhe Qeveria gëzojnë besimin më të madh në mesin e punonjësve në sektorin publik, të cilët vlerësuan besimin në këto institucione me 5.0 përkatësisht 4.2. Qytetarët kanë besimin më të ulët në gjyqësor, pavarësisht nga statusi i tyre i punësimit, ndërsa besim më të lartë tek Presidenti i vendit.

**Grafiku 8.** Besimi në institucionet sipas statusit të punësimit (në shkallë prej 1 deri në 10)




Sipas perceptimit të të anketuarve për gjendjen e tyre aktuale ekonomike, sa më të pasigurt dhe të paqartë e konsiderojnë gjendjen e tyre aktuale ekonomike, aq më e ulët është nota e besimit në institucionet kryesore të sistemit politik. Qytetarët që thanë se gjendja e tyre aktuale ekonomike është shumë e pasigurt kanë besimin më të ulët në të katër institucionet, me notë mesatare nën 3.0, ndërsa të anketuarit që thanë se aktualisht kanë një situatë mjaft të sigurt ekonomike kanë besimin më të lartë në institucionet demokratike të vendit.

**Grafiku 9.** Besimi në institucionet sipas sigurisë ekonomike (në shkallë prej 1 deri në 10)




Sipas grup moshave, të anketuarit më të rinj, të moshës 18 deri në 29 vjeç, kanë besimin më të ulët në institucionet më të rëndësishme të sistemit politik. Presidenti gëzon besimin më të lartë, me notë 4.6 te grup moshë 60+, dhe Kuvendi dhe Qeveria te grup moshë 30 - 39 vjeç, me notë 3.7 përkatësisht 3.8.

**Grafiku 10.** Besimi tek institucionet sipas grupmohave (në shkallë prej 1 deri në 10)



Një besim relativisht më të lartë ka ushtria, me notë prej 5.6, dhe kisha, me notë prej 5.5, dhe në mes të shkallës janë institucionet shëndetësore dhe ekspertët me notë prej 5.0, gjë që nuk ndodh me besimin në media, të cilat vlerësohen me 4.0. Të anketuarit gjithashtu kanë një nivel të ulët besimi tek politikanët (3.2) dhe partitë politike (3.4). Në gjysmën e poshtme të shkallës janë rrjetet sociale (3.5), OJQ -të (3.6), pushteti lokal (4.1), administrata publike (4.2), policia (4.6) dhe kompanitë private (4.6).

**Grafiku 11.** Besimi në institucionet demokratike dhe aktorët e tjerë (në shkallë prej 1 deri në 10)



Besimi relativisht i ulët në institucionet dhe tek aktorët politikë dhe shoqërorë reflekton mosbesimin e përgjithshëm ndaj elitave politike dhe shoqërore dhe ilustron potencialin për kërkesë populiste në vend. Mosbesimi ndaj institucioneve dhe elitave mund të çojë në votimin e kandidatëve populistë dhe forcimin e ofertës populiste. Në këtë kuptim, rritja e besimit në institucionet duke forcuar pavarësinë dhe efektivitetin e tyre mund të jetë vendimtare në trajtimin e pasojave të dëmshme të populizmit në periudhën e ardhshme.


### • **Përballja: “Ne kundrejt tyre”**

Dualizmi “Ne kundrejt tyre” është gjithashtu shumë i pranishëm në botëkuptimin populist dhe është i lidhur ngushtë me mosbesimin ndaj elitave politike dhe zhgënjimin me rregullat demokratike të lojës. Politika shihet si një betejë e “gjithçka ose asgjë”, në të cilën ka pak vend për të pranuar opinionet e aktorëve të tjerë shoqërorë. Këto qëndrime janë gjithashtu shumë të pranishme në mesin e popullatës, me disa dallime midis grupeve demografike. Kështu, shumica e të anketuarve pajtohen me pohimin “Politika është në thelb një luftë midis së mirës dhe së keqes” (58%), ndërsa një numër i vogël i të anketuarve (14%) mendojnë të kundërtën. Të anketuarit të më të rinjtë (18-29 vjeç) dhe te kategoria më e vjetër e moshës (60+ vjeç) në një numër të madh pajtohen me këtë pohim të të anketuarve në kategoritë e tjera të moshës.

Edhe pse një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve pajtohen me deklaratën “Në demokraci, është e rëndësishme të arrihet një kompromis midis pikëpamjeve të ndryshme” (76%, në krahasim me një pakicë shumë të vogël prej 3% që mendojnë ndryshe), prapë gati gjysma e të anketuarve pajtohen se “Kompromisi në politikë nënkupton shitjen e parimeve të veta” (45%, kundrejt 27% që nuk pajtohen me të njëjtën deklaratë). Këto gjetje tregojnë se edhe pse qytetarët perceptojnë se kompromisi është i rëndësishëm për procesin demokratik, ai prapë shihet si diçka që mund të çojë në dëm të konsiderueshëm për grupin e tyre. Pajtimi se kompromisi është në praktikë i dëmshëm për grupin e tyre është disi më i përhapur te maqedonasit etnikë sesa te shqiptarët etnikë: shumica prej 52% e maqedonasve pajtohen me këtë deklaratë (dhe 27% nuk pajtohen), krahasuar me 47% të shqiptarëve (ndërsa 36% nuk pajtohen). Të anketuarit me arsim fillor në shumicë pajtohen me këtë pikëpamje (54%), ndërsa të anketuarit me arsim të lartë shprehin mosmarrëveshjen më të madhe (37%), krahasuar me grupet e tjera arsimore. Votuesit e VMRO-DPMNE-së pajtohen me shumicë dërrmuese se kompromisi është i barabartë me shitjen e parimeve (62%), ndërsa votuesit e partive të tjera politike janë më të moderuar në këtë çështje.

Në mënyrë të ngjashme, edhe pse shumica dërrmuese e të anketuarve u pajtuan me pohimin “Në politikë, është e rëndësishme të dëgjosh mendimin e grupeve të tjera” (81%), vetëm 29% e të anketuarve nuk pajtohen se “Promovimi i të drejtave të njerëzve të ndryshëm nga unë e kufizon lirinë time”. Paragrafi i fundit ndahet nga shumica e të anketuarve në grupin më të ulët arsimor (56%). Si pasojë, qytetarët tregojnë gatishmëri deklarative për të pranuar dallimet në politikë, por kjo gatishmëri zvogëlohet ndjeshëm kur duhet të zbatohet në praktikë dhe kur nënkupton pasoja të mundshme negative për grupin e tyre. Shqiptarët më shpesh dhe në shumicë kundrejt maqedonasve (53% kundrejt 47%) pajtohen me pohimin “Promovimi i të drejtave të njerëzve të ndryshëm nga unë kufizon lirinë time”, si dhe shumica e punonjësve të sektorit privat (52%) dhe të papunët (54%). Shumica e votuesve të VMRO-DPMNE (54%) dhe BDI (63%), si dhe shumica e abstenuesve (51%), pajtohen se promovimi i të drejtave të të tjerëve kufizon lirinë e tyre personale. Edhe shumica e votuesve të Aleancës për Shqiptarët (40%) dhe të Majtës (43%) janë dakord me deklaratën. Përkundrazi, shumica e votuesve të LSDM-së (43%) janë shprehur se nuk pajtohen me këtë deklaratë.

**Grafiku 12.** Qëndrimet për politikën si një arenë bashkëpunimi dhe konflikti (% e pajtimit me pohim)




## • Ekziston një lidhje e fshehtë: Teoritë e komplotit si botëkuptime

Prirja ndaj teorive të komplotit tregon potencialin për shfrytëzimin e trupit votues në një proces politik konfrontues. Teoritë e komplotit sugjerojnë një botëkuptim në të cilin politika nuk mund të jetë proces demokratik, por rezultat i punës së grupeve sekrete që kontrollojnë rrjedhën e historisë. Duke vepruar kështu, kontrolli vendoset mbi proceset shoqërore, por nganjëherë mbi ato natyrore siç është ndryshimi i klimës. Një botëkuptim i tillë, në të cilin individi është aq larg jo vetëm nga procesi politik, por edhe nga ndjenja e kontrollit, përforcon pasigurinë që mund të shfrytëzohet nga aktorët politikë. Kështu, duke përdorur teoritë e komplotit, këta aktorë politikë mund të fitojnë mbi individët, duke i përfshirë në gjoja ata në luftën kundër grupeve të fshehta të komplotit.

Hulumtimi tregoi se ekziston një potencial domethënës midis qytetarëve në drejtim të prirjes ndaj teorive të komplotit. Kështu, 72% e të anketuarve besojnë se bota sundohet nga disa familje të fuqishme, 65% mendojnë se COVID-19 është krijuar në një laborator për të kontrolluar njerëzit, 46% se klima kontrollohet nga satelitët dhe radarët, 44% se janë regjistruar më shumë të vdekur nga COVID sepse Ministria e Shëndetësisë ka dhënë para, 46% se virusi u spërkat nga aeroplanët, 29% mendojnë se ndryshimet klimatike janë një sajësë dhe 57% që mediat e mëdha përhapin gënjeshtër.

**Grafiku 13.** Prirje ndaj teorive të komplotit (%)



Analiza e kryqëzuar tregon se votuesit e LSDM-së dhe koalicionit besojnë më pak në këto teori sesa votuesit e koalicionit të paraprirë nga VMRO-DPMNE, votuesit e BDI-së, atyre të Aleancës për Shqiptarët dhe E Majta. Kështu, 69% e votuesve të LSDM-së besojnë se bota drejtohet nga disa familje, krahasuar me 82% të VMRO-DPMNE-së, 79% të BDI-së, 85% të Aleancës për Shqiptarët dhe 86% të së Majtës. Dallimi është drastik për sa i përket opinionit në lidhje me krijimin artificial të COVID-19 dhe përdorimin e tij për kontrollin e njerëzve. Këtë qëndrim e kanë rreth 55% e votuesve të LSDM-së, 77% e votuesve të së Majtës, ndërsa të njëjtën gjë e besojnë mbi 83% të votuesve të VMRO-DPMNE-së, BDI-së dhe votuesve të Aleancës për Shqiptarët (88%). Gati një në tre votues të LSDM-së (34%) besojnë se klima kontrollohet nga satelitët dhe radarët, 52% nga mbështetësit e së Majtës, dhe ky qëndrim është i pranishëm në më shumë se dy në çdo tre votues të VMRO-DPMNE (70%), BDI (67%) dhe Aleancës për Shqiptarët (65%). Dallimi është më drastik në pikëpamjet për falsifikimin e vdekjeve nga COVID-19. Kështu, 24% e votuesve të LSDM-së mendojnë se numri i vdekjeve të regjistruara është më i madh se ai real, që është rasti me rreth dy të tretat e votuesve të VMRO-DPMNE-së, BDI-së dhe Aleancës për Shqiptarët, dhe me më shumë se gjysmën e votuesve të së Majtës. Ngjashëm është edhe me mendimin se nga avionët spërkaten viruse, e cila është e pranishme tek 33% e votuesve të LSDM-së, 64% e votuesve të BDI-së dhe Aleancës, 66% e votuesve të së Majtës dhe 67% e votuesve të VMRO-DPMNE-së. Pothuajse çdo i dyti votues i LSDM-së (45%) mendon se nuk mund t'u besohet mediave të mëdha, që është rasti me rreth dy të tretat e votuesve të VMRO-DPMNE-së, BDI-së (68%) dhe Aleancës për Shqiptarët (58%). Të njëjtin qëndrim kanë 68% e votuesve të së Majtës. Një e katërta e votuesve të LSDM-së (26%) nuk besojnë në ndryshimet klimatike, 28% e mbështetësve të së Majtës, 41% e Aleancës për Shqiptarët dhe rreth gjysma e votuesve të VMRO-DPMNE (48%) dhe BDI (48%) kanë të njëjtin mendim.

Brezi midis moshave 30 dhe 39 vjeç është më skeptik ndaj teorive të komplotit sesa grup moshat e tjera. Kështu, ky grup pajtohet dukshëm më pak me teorinë se pandemia u krijua në një laborator për kontrollin e njerëzve (63%) në krahasim me grup moshat e tjera, ku përqindja është mbi 70. Është e ngjashme me teorinë e kontrollit satelitor të klimës, me të cilën pajtohen 47% e këtij brezi, dhe mes brezave të tjerë, mbi 55% e njerëzve ndajnë këtë mendim. Ekziston një ndryshim i ngjashëm në pikëpamjen se Ministria e Shëndetësisë i ka dhënë rryshfet familjeve për të raportuar vdekjet nga COVID-19. Në lidhje me teorinë e tjera, ky brez nuk veçohet, pra nuk ka dallime të rëndësishme.

Arsimi i lartë është një faktor që ndikon në ndjeshmërinë ndaj teorive të komplotit. Kështu, ekziston një ndryshim i dukshëm në qëndrimet për pandeminë, ku 65% e njerëzve me arsim të lartë besojnë se është krijuar për të kontrolluar njerëzit, në krahasim me 74% të atyre me

arsim të mesëm. 43% e atyre me arsim të lartë mendojnë se klima kontrollohet nga radarët dhe satelitët, në krahasim me 58% të atyre me arsim të mesëm dhe 62% - me fillore. Është e ngjashme me teorinë e falsifikimit të numrit të të vdekurve nga COVID-19, ku 43% e njerëzve me arsim të lartë mendojnë se Ministria ka paguar ryshfet, ndërsa i njëjti mendim është i pranishëm në 53% të atyre me arsim të mesëm dhe 61% te ata me arsim fillor. Sa i përket nivelit të arsimimit, ndryshimi është i dukshëm në teorinë se ndryshimi i klimës është një sajese, por kjo është midis atyre me arsim fillor (42%) dhe atyre me arsim të mesëm dhe të lartë (rreth 30%).

Analiza tregon një trend interesant tek të papunët. Krahasuar me të punësuarit (të punësuarit formalë dhe joformalë si dhe ata me honorar), janë më të ndjeshëm ndaj teorive të komplotit. Ekziston një ndryshim domethënës midis këtyre dy kategorive në lidhje me pandeminë, ku 78% e të papunëve besojnë se është krijuar për kontroll, dhe ky qëndrim ndryshon midis 66% dhe 73% te kategoritë e të punësuarve. Rreth 63% e të papunëve besojnë se klima është e kontrolluar dhe ky qëndrim midis punonjësve ndryshon midis 47% dhe 58%. Dy të tretat e të papunëve mendojnë se numrat e vdekjeve nga COVID-19 janë falsifikuar, dhe ky qëndrim ndryshon midis 42% dhe 50% në kategoritë e punës. Vihen re dallime edhe në qëndrimin ndaj vërtetësisë së lajmeve në mediat e mëdha, të cilave 70% e të papunëve nuk i besojnë, gjë që është rasti midis 56% dhe 63% në grupet në kategorinë e "statusit në marrëdhënie pune".

## • **Përfundim**

Ndërsa hulumtimi mbi tendencat populiste në mesin e qytetarëve kërkon analiza më të thella dhe hulumtime më të gjera, ky raport është një përpjekje fillestare për të dokumentuar anën e kërkesës së populizmit në Maqedoninë e Veriut përmes një pyetësi anketues. Pyetësi analizon në detaje qëndrimet e qytetarëve lidhur me **mosbesimin e theksuar ndaj elitave politike, të cilët përgjithësisht perceptohen si të korruptuar dhe kryesisht të interesuar për interesat personale.**

Këto pikëpamje reflektohen në **një pikëpamje kryesisht negative për politikanët, të cilët të anketuarit i konsiderojnë se punojnë vetëm për veten e tyre.** Për më tepër, një pjesë e madhe e të anketuarve konsiderojnë se **“populli” është një entitet që është moralisht superior ndaj elitave,** në atë që populli është pozicionuar diametralisht në anë të kundërt me elitat dhe shihet si një forcë homogjene dhe moralisht superiore, ndërsa elitat si të korruptuara dhe në shërbim të vetvetes.

Këto pikëpamje u panë gjithashtu në eksperimentin e anketës, në të cilin shumica e të anketuarve preferuan kandidatin e dytë ose “njeriun e popullit” kundrejt një “politikan karriere”. Për më tepër, ekziston një ndryshim midis votuesve të subjekteve të ndryshme politike në vend, sipas të cilit votuesit e partive politike në pushtet në përgjithësi preferojnë kandidatin e parë, ndërsa votuesit e partive politike opozitare preferojnë kandidatin e dytë.

Një ndikim të madh në ndezjen e kërkesës për populizëm ka dhe **mosbesimi i përgjithshëm ndaj institucioneve demokratike dhe rregullave të lojës.** Veçanërisht i rëndësishëm është mosbesimi i konsiderueshëm ndaj zgjedhjeve, si mekanizëm kyç demokratik në një demokraci përfaqësuese, por edhe ndaj vetë aktit të votimit. Ekziston gjithashtu një nivel i ulët besimi në institucionet e zgjedhura në mënyrë demokratike dhe aktorët e tjerë socialë, me nivelin më të ulët të besimit të qytetarëve në institucionet më të rëndësishme të sistemit politik të vendit, të tilla si Kuvendi, Qeveria, Presidenti dhe gjyqësori. Ky mosbesim i përgjithshëm në shumicën e aktorëve shtetërorë dhe shoqërorë ndikon në prirjen e qytetarëve drejt udhëheqësve populistë dhe zgjidhjen e problemeve të tyre.



Marrë në tërësi, të anketuarit shprehin **kuptim të politikës dhe jetës politike si një luftë e “ne kundër tyre”**, dhe më pak si një aktivitet përmes të cilit duhet të jetë e mundur të zgjidhen problemet sociale, në përputhje me interesat e grupeve të ndryshme. Niveli i lartë i mosbesimit në institucionet demokratike dhe rregullat e lojës gjithashtu ndikon në rritjen e **ndjeshmërisë ndaj teorive të komplotit, të cilat po bëhen më të përhapura në nivel global**. Tendenca në rritje për të besuar në teoritë e komplotit tregon një abuzim të mundshëm të cënueshmërisë së qytetarëve për përfitime politike nga politikanët populistë, të cilët shpesh përdorin retorikë nxitëse për të fituar pikë politike.

## Informacione rreth IDSCS-ë

---

Instituti për Demokraci "Societas Civilis" Shkup (IDSCS) është një organizatë think tank që hulumton zhvillimin e qeverisjes së mirë, sundimin e ligjit dhe integrimin evropian të Maqedonisë së Veriut. IDSCS ka mision të ndihmojë përfshirjen qytetare në vendimmarrje dhe të forcojë kulturën participative politike. Përmes forcimit të vlerave liberale, IDSCS kontribuon në bashkëjetesën e diversiteteve.

### **Të dhëna për kontakt, për IDSCS**

---

Adresa: rr. Miroslav Krlezha 52/2,  
1000 Shkup  
Tel.nr./ Faks: +389 2 3094 760  
Posta elektronike: [contact@idscs.org.mk](mailto:contact@idscs.org.mk)

## Link

---

**Ky botim është në dispozicion në mënyrë elektronike në:**

[https://idscs.org.mk/en/?post\\_type=portfolio&p=13245](https://idscs.org.mk/en/?post_type=portfolio&p=13245)

## Informacion mbi projektin

---

Ky hulumtim është realizuar nga Instituti për Demokraci "Societas Civilis" Shkup, në bashkëpunim me Zyrën e Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në kuadër të bashkëpunimit të vendosur me Shkollën e Politikave të Qendrës Presidenciale për Edukim Politik. Qëllimi i këtij hulumtimi është të shqyrtoj pikëpamjet e qytetarëve për disa tema që kanë të bëjnë me politikën dhe demokracinë, me fokus mbi kërkesën sociale për liderë dhe politika populiste në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

## Për autorët

---

**Misha Popoviq** është hulumtues i lartë dhe udhëheqës i Qendrës për qeverisje të mirë në kuadër të Institutit për Demokraci (IDSCS). Ka magjistruar në studimet mbi nacionalizmin në Shkollën e Studimeve Sllave dhe Evropës Lindore. Që nga viti 2015 është anëtar i bordit të Platformës së organizatave të shoqërisë civile për luftë kundër korrupsionit. Interesat e tij kërkimore lidhen me zhvillimin institucional dhe faktorët social të sjelljes joformale dhe korrupsionit.

**Vlora Reçica** është hulumtuese dhe udhëheqëse e Qendrës për Mbështetje Parlamentare dhe Demokratizim në kuadër të Institutit për Demokraci (IDSCS). Ka magjistruar në studimet mbi politika krahasuese dhe specializuar mbi temën demokraci dhe demokratizim në Shkollën e Ekonomisë dhe Shkencave Politike në Londër (LSE). Fokusi i saj i hulumtimit dhe avokimit është mbi parlamentet dhe demokracinë parlamentare, ndërtimin dhe zhvillimin institucional, populizmin dhe proceset e demokratizimit në demokracitë në zhvillim.

**Jovan Bliznakovski** është politolog me doktoraturë në Universitetin e Milanos, Itali dhe diplomë master në Universitetin e Lubjanës, Slloveni. Ai ka përvojë shumëvjeçare në think tank sektorin maqedonas dhe është autor i disa

studimeve për marrëdhëniet ndëretnike në Maqedoninë e Veriut, klientelizmin politik në shoqëritë e Ballkanit Perëndimor, si dhe raportet e Freedom House “Kombet në tranzicion” për Maqedoninë e Veriut për vitin 2017, 2018 dhe 2020. Në periudhën 2014 - 2016 ka qenë drejtor programi i Institutit për Demokraci “Societas Civilis” (IDSCS), ndërsa aktualisht punon në Institutin për Kërkime Sociologjike dhe Politike-Juridike (ISPPi) në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup.

**Toshe Zafirov** punon si zëvendëssekretar i përgjithshëm në kabinetin e Presidentit. Me më shumë se një dekadë përvojë në sektorin civil, ai ka punuar në Institutin Progres si drejtor programi për shumë projekte vendase dhe ndërkombëtare. Në zyrën e Presidentit kryesohet fokusohet tek politikat e brendshme, bashkëpunimi me sektorin e shoqërisë civile dhe organizatat think-tank politike, projektet nga programi i Presidentit, komunikimi digjital dhe digjitalizimi, mbështetja dhe përfshirja e të rinjve, si dhe mbështetja për grupet vulnerabël. Zafirov është diplomuar për shkenca politike në Fakultetin Juridik “Justiniani I” në Universitetin “Shën Kirili and Metodi” në Shkup, në drejtimin publiku, opinion publik dhe komunikimi masiv dhe ka magjistruar mbi temën marrëdhënie me publikun nga fakulteti juridik “Justinian I”. Ai është autor i disa botimeve dhe hulumtimeve, ligjërues në trajnime të shumta në fushën e komunikimeve digjitale, fushat politike, marketingu politik, avokimi dhe lobimi, si dhe krijimi i politikave publike.

Analizë e opinionit publik No.33/2021

---

# Njeri i popullit: Analizë e opinionit publik mbi kërkesat politike të qytetarëve

Autorë: Jovan Blizankovski, Vlora Reçica,  
Misha Popoviq dhe Toshe Zafirov

-  
nëntor 2021

